



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1591/1 Prot.

Tiranë, më 26 . 11 . 2025

V E N D I M

Nr. 270 , datë 26 . 11 . 2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 262 Regj., datë 12.11.2025, të shtetasit D. Ll, kundër Shkollës së Drejtorëve të Institucioneve të Arsimit Parauniversitar dhe Agjencisë Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes arsimore.”

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Bazuar në parashtrimet si dhe dokumentacionin e përcjellë pranë KMD-së, nga subjekti ankues, z. D. Ll, evidentohet se, ai ka aplikuar në Programin e Trajnimit të Detyrueshëm Përgatitor për Certifikimin e Drejtuesve të Institucioneve të Arsimit dhe Formimit Profesional (Thirrja e III, AFP: 15 Janar-15 Shkurt 2025).

Me datë 27 Tetor 2025, z. Ll, nëpërmjet e-mailit është vënë në dijeni se nuk ishte shpallur fitues në këtë Program, për t’u certifikuar si drejtues i institucioneve të arsimit dhe formimit profesional.

Pas marrjes së njoftimit sipërcituar, ankuesi ka kërkuar t’i vihej në dispozicion tabela e pikëzimit, me qëllim njohjen e detajuar të rezultateve të procesit të vlerësimit.

Pas kërkesës së tij, nga ana e Shkollës së Drejtorëve të IAP-së i është vënë në dispozicion tabela e pikëzimit, në të cilën rezulton një vlerësim përfundimtar prej 59 pikësh nga 100 pikë në total, pra nën pragun minimal të përcaktuar në nenin 18, pika 8, të “Rregullores për zhvillimin profesional dhe kualifikimin e drejtorëve/aspirantëve për drejtues të institucioneve të arsimit parauniversitar në Shqipëri”, ku përcaktohet se:

“Aplikantët të cilët grumbullojnë të paktën 60 pikë nga pikëzimi i kriterëve vlerësuesë për zgjidhen për të ndjeur programin e trajnimit.”

¹ Në vijim do t’i referohemi me akronimin: KMD.

Subjekti ankues, ndër të tjera, pretendon se, kriteret e përzgjedhjes së kandidatit sipas IAL, janë shkelur në vlerësimin që i është bërë atij, duke cituar se:

“Nga analiza e pikëzimit dhe mospërputhjet e konstatuara dhe nga e-maillet e dërgura, krijohet dyshimi se procesi i vlerësimit nuk është zhvilluar mbi bazën e kriterëve objektive dhe të njëjta për të gjithë kandidatët, por ka qenë i ndikuar nga elementë subjektivë që kanë sjellë trajtim të pabarabartë ndaj meje.

Në mënyrë të veçantë, karakteristika ime profesionale si mësues me përvojë në arsimin profesional dhe me kategori “Mësues i Kualifikuar”, që, në kushte normale përbën avantazh sipas kriterëve të publikuara, është trajtuar në të kundërt, duke rezultuar në ulje të pajustificuar të pikëve në disa kategori.

Kjo krijon dyshimin e arsyeshem për një sjellje diskriminuese ose paragjyquese. Për këto arsye, kërkoj që, përveç vënies në dispozicion të dokumentacionit të plotë, të shqyrtohet edhe dyshimi për trajtim të pabarabartë gjatë procesit të vlerësimit dhe të ndërpriten veprimet administrative përkatëse për garantimin e barazisë në procedurë.

Vërejtjet e mia mbi procesin e vlerësimit janë si më poshtë citohet:

- 1. Mospërputhje në kriteret e kualifikimit - janë dhënë 3 pikë nga 10, pa bazë në udhëzimet përkatëse;*
- 2. Letra e motivimit – vlerësuar me 5 pikë nga 10, pa koment apo standard të qartë;*
- 3. Trajnimet e vazhduara – vlerësuar me 3 pikë nga 15, në kundërshtim me dokumentacionin e dorëzuar prej meje;*
- 4. Projekti profesional – vlerësuar me 17 pikë nga 30, pa arsyetim të dokumentuar;*
- 5. Dyshim mbi manipulimin e rezultatit – për shkak të diferencës minimale (59/100), që rezulton nën pragun prej 60 pikësh;*
- 6. Në komunikimin zyrtar me datë 4 nëntor 2025, është cituar se Komisioni i vlerësimit është përbërë nga 3 (tre) anëtarë, përkatësisht një përfaqësues i Shkollës së Drejtorëve dhe 2 (dy) përfaqësues të Agjencisë Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional.*
- 7. Ky fakt ngre dyshime serioze se disa nga anëtarët e Komisionit mund të kenë ndikuar në mënyrë të qëllimshme në uljen e vlerësimit tim. Me qëllim që të pengohet kualifikimi im në këtë proces.*

Kërkoj që Shkolla e Drejtorëve të IAP të vërë në dispozicion:

- Listën emërore të anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Dosjeve;*
- Vlerësimin individual për dosjen personale, me pikët, komentet dhe kriteret e përdorura;*
- Formularët individualë të vlerësimit të projektit dhe të letrës së motivimit, të plotësuar e nëshkruar nga çdo anëtar i Komisionit;*
- Çdo udhëzim, kriter, rubrikë apo standard vlerësimi mbi të cilin është bazuar Komisioni gjatë procesit të pikëzimit.”*

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës së tij, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri:

- “Të verifikojë nëse procesi i vlerësimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve nga Shkolla e Drejtorëve të IAP-së ka përmbajtur të elementëve të diskriminimit indirekt, përmes*

përdorimit të kriterëve, procedurave apo praktikave që kanë vendosur kandidatë të caktuar në pozita të pafavorshme krahasuar me të tjerët.

- *Të kërkojë nga Shkolla e Drejtorëve të IAP-së dhe AKAFP, dokumentacionin e plotë mbi mënyrën e vlerësimit, për të vlerësuar nëse ka pasur trajtim të pabarabartë apo subjektiv ndaj aplikantëve.*
- *Të konstatojë nëse është shkelur parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit në përzgjedhjen e kandidatëve për Programin e Trajnimit të Detyrueshëm Përgatitor.*
- *Të rekomandojë marrjen e masave korrigjuese, lidhur me vlerësimin tim individual, përmirësimin e procedurave të vlerësimit për të shmangur raste të ngjashme në të ardhmen, trajnimin e anëtarëve të komisioneve vlerësuese mbi standardet e mosdiskriminimit dhe barazisë në përzgjedhje.*
- *Nëse konstatohet diskriminim, të urdhërojë institucionet përgjegjëse të ndërmarrin masa administrative dhe të garantojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët në proceset e ardhshme.”*

Pas regjistrimit të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, (përfshirë dhe identifikimin e provueshmërinë e shkakut të pretenduar nga ana e subjektit ankues) dhe për këtë arsye, është kontaktuar nga specialistja e Drejtorisë së Pritjes së Ankesave nëpërmjet e-mailit datë 05.11.2025, dhe i është kërkuar të plotësojë informacionin e dokumentacionin e nevojshëm.

Në përgjigje të kërkesave të mësipërme, subjekti ankues ka dërguar me e-mail² sa është kërkuar nga KMD.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimorë ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

² E-mail i datës 05.11.2025.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Dokumentimi i tyre është thelbësor në çështjen e provimit të “shkakut” për të cilin subjekti ankues pretendon se si pasojë e posedimit të tij i kanë ardhur më pas të gjitha pasojat e pretenduara. Në rastin e mosprovimit e mosdokumentimit të “shkakut”, nuk mund të dilet në përfundimin se paligjshmëritë e pretenduara nga subjekti ankues lidhen pikërisht me këtë “shkak”.

Në këtë kontekst, Komisioneri për të vlerësuar nëse pretendimet e subjektit ankues për trajtim të pabarabartë apo të padrejtë e të pafavorshëm nga ana e subjekteve kundër të cilëve është ankuar (*Shkollës së Drejtorëve të Institucioneve të Arsimit Parauniversitar dhe Agjencisë Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional*), vijnë për shkakun e pretenduar, duhet që fillimisht ky shkak të jetë i provuar e dokumentuar para KMD-së, si shkak i njohur nga LMD.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim, Komisioneri vlerëson se, personi i cili pretendon se është diskriminuar për këto shkaqe, por jo vetëm, duhet gjithashtu të parashtrojë fakte nga të cilat mund të vlerësohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun/shkaqet e mbrojtura, që në çështjen objekt shqyrtimi paraprak, është *gjendja arsimore*.

Subjekti ankues, në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, evidenton faktin se, shpallja e tij si kandidaturre jo fituese për të marrë pjesë në Programin e Trajnimit të Detyrueshëm Përgatitor (thirrja e III, 15 janar – 15 shkurt 2025), ka ardhur për shkak të gjendjes arsimore të tij.

Ai ka shpjeguar se plotëson kriterin e arsimimit dhe kualifikimit të kërkuar, lidhur me aplikimin e shpallur në thirrjen respektive.

Bazuar në dokumentin “Dëshmi kualifikimi”, (2021) lëshuar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar/MASR, vërtetohet se, z. D. Ll ka fituar kategorinë e III, Mësues i Kualifikuar, për vitin 2020-2021, në Arsim Profesional (AP), duke u vlerësuar “Shumë mirë”.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshton të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të

gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllajta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë”³*

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, ndërkohë që Protokollin 12-të të KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se “diskriminimi” do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet. Sipas GJEDNJ, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çenohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve objektivisht e ndryshme.

Ligji nr. 10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me një listë të hapur shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të ndrejtëpërdrejtë mbrojtjen nga diskriminimi respektivisht edhe për shkaqet e pretenduara nga ankuesi.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e *dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës* dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në

³ Shih vendimet nr.39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese.

mungesë të një shkaku të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit.

Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Duke mbajtur në konsideratë standardet dhe parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioneri vlerëson se, ankuesi ka ngritur pretendime për trajtim të padrejtë e të pafavorshëm nga ana e subjekteve kundër të cilëve ka paraqitur ankesën pranë KMD-së⁴, duke pretenduar se është gjendur në një situatë diskriminuese, situatë e cila supozohet se ka si shkak gjendjen arsimore me shpjegimin se: *“Në mënyrë të veçantë, karakteristika ime profesionale si mësues me përvojë në arsimin profesional dhe me kategori “Mësues i Kualifikuar”, që, në kushte normale përbën avantazh sipas kriterëve të publikuara, është trajtuar në të kundërt, duke rezultuar në ulje të pajustificuar të pikëve në disa kategori.”*

Në kuptim të LMD-së, *“Shkak i mbrojtur është një karakteristikë e identifikueshme, objektive apo personale, ose “status”, nga të cilat individët ose grupet e individëve janë të dallueshëm nga njëri-tjetri.”*⁵.

Shkolla e Drejtorëve të Institucioneve të Arsimit Parauniversitar, në faqen zyrtare të ëeb-it të saj, ka hapur thirrjen e III për aplikime në Programin e Trajnimit të Detyrueshëm Përgatitor për Certifikim për drejtues të AFP⁶, duke pasqyruar si më poshtë vijon:

“Thirrja është e hapur për të gjithë Drejtorët/Zëvendësdrejtorët në detyrë, si dhe për mësues që aspirojnë për t’u bërë drejtorë apo Zëvendësdrejtorë në Institucionet Ofruese të Arsimit dhe Formimit Profesional. Kandidatët e interesuar, përpara se të fillojnë përgatitjen e dokumenteve për aplikim, duhet të sigurohen që të plotësojnë kriteret e shpallura si më poshtë:

- 1. të ketë diplomë të studimeve universitare master shkencor ose të barasvlershëm me të;*
- 2. të ketë 3 (tre) vjet përvojë pune nga të cilat 1 (vit) përvojë pune në menaxhim.*
- 3. të ketë njohuri të certifikuara të përdorimit të teknologjisë së informacionit;*
- 4. preferohet të ketë njohuri të gjuhës angleze dhe/ose të gjuhëve të huaja të tjera.*

Dokumentet e nevojshme që kandidati i interesuar duhet të dorëzojë dhe mënyra e aplikimit përcaktohet si më poshtë. Të dhënat e kandidatëve do të grumbullohen duke respektuar Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

⁴ Shkollës së Drejtorëve të Institucioneve të Arsimit Parauniversitar dhe Agjencisë Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional

⁵ <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>

⁶ <https://csl.edu.al/neës/thirrjen-e-iii-per-aplikime-ne-programin-e-trajnim-te-detyrueshem-pergatitor-per-certifikim-per-drejtues-te-afp/>

Dokumentet e nevojshme për aplikim janë:

- *Kërkese për aplikim për Programin e Trajnimit;*
- *Letër motivimi i/e aplikantit;*
- *CV i/e aplikantit sipas modelit Europass;*
- *Fotokopje e dokumentit të identifikimit të vlefshëm;*
- *Mandat pagese për tarifën e aplikimit në vlerën prej 1000 lekë të reja, në llogarinë bankare të Shkollës së Drejtorëve*
- *Vërtetim për masa disiplinore lëshuar nga punëdhënësi*
- *Eksperienca në menaxhim (e përgjithshme jashtë ose/dhe brenda IOAFP-së)*
- *Certifikata të trajnimeve të zhvilluara në fushën e menaxhimit dhe lidërshiptit, diplomë gjuhë të huaj dhe TIK.*
- *Formular vetë deklarimi që aplikanti nuk ka qene i dënuar penalisht;*
- *Projekt për zhvillimin e institucionit të sistemit parauniversitar mbështetur në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit të Sistemit Parauniversitar në Shqipëri.*
- **Kopje të Diplomave universitare, të Listave përkatëse të notave dhe të Licencës për ushtrimin e profesionit (nëse e kanë);*
- **Vërtetim të eksperiencës si drejtues, Kopje të Kategorisë së Kualifikimit (nëse e kanë), Dëshmisë së Gjuhës së huaj dhe TIK;*
- *Letër rekomandimi nga drejtuesi i institucionit. Në rastin kur aplikanti nuk është aktualisht në marrëdhënie pune, letrën e rekomandimit duhet ta marri nga institucioni arsimor i punësimit të tij më të fundit.*

Aplikimet do të pranohen gjatë periudhës 15 Janar -15 Shkurt 2025.

Aplikimet do të shqyrtohen nga Komisioni i vlerësimit të kandidatëve sipas kategorive dhe pikëzimit të përcaktuar në “Për zhvillimin profesional dhe kualifikimin e drejtorëve/zëvendësdrejtorëve të institucioneve të arsimit dhe formimit profesional në Shqipëri”.

Shkolla e Drejtorëve organizon procesin e vlerësimit, pranimin dhe regjistrimin të drejtuesve në detyrë në programin e trajnimit për drejtuesit e institucioneve të arsimit dhe formimit profesional në Shqipëri, sipas rregullores “Për zhvillimin profesional dhe kualifikimin e drejtorëve/zëvendësdrejtorëve të institucioneve të arsimit dhe formimit profesional në Shqipëri” të miratuar nga Bordi Drejtues i Shkollës së Drejtorëve.”

Rregullorja “Për zhvillimin profesional dhe kualifikimin e Drejtorëve/Nëndrejtorëve të Institucioneve të Arsimit Parauniversitar në Shqipëri”, (Rregullorja) ka për qëllim të përcaktojë rregullat dhe procedurat e aplikimit, organizimit dhe vlerësimit të IAL apo subjekteve të tjera, si ofruesit kryesorë të Programit të trajnimit e detyrueshme për pajisjen me certifikatë për drejtimin e Institucioneve të Arsimit Parauniversitar, në funksion të zhvillimit të profesionat të drejtorit/nëndrejtorit.

Rregullorja përcakton kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes, procedurën e aplikimit, afatet përkatëse, dokumentacionin shoqërues për aplikim, përzgjedhjen e kandidatëve që do të përfshihen në Programin e trajnimit të detyrueshëm përgatitor.

Në nenin 4⁷, të Rregullores, përcaktohet se:

1.Shkolla e Drejtorëve hap thirrjen për procesin e aplikimit të IAL-ve apo subjekteve të tjera qofshin këta persona fizikë apo juridikë për realizimin e Programit të Trajnimit të Detyrueshëm Përgatitor për certifikim të drejtuesve dhe aspirantëve për drejtues të IAP. Shkolla e Drejtorëve publikon në faqen e saj zyrtare, dokumentin “Shpallje e interesit për zhvillimin e Programit të Trajnimit të Detyrueshëm Përgatitor për drejtues të IAP, duke përcaktuar afatet e vlefshmërisë së thirrjes.

2.Thirrja për shpalljen e interesit duhet të përmbajë të paktën informacionin si më poshtë:

- a. Kriteret që duhet të plotësojë IAL apo subjektet e tjera qofshin këta persona fizikë apo juridikë të interesuar për ofrimin e moduleve të Programit të Trajnimit të Detyrueshëm Përgatitor;
- b. Përshkrimin e qëllimit dhe të objektivave të programit;
- c. Përcaktimin e programit bazë të detajuar, i ndarë në module, orë mësimore dhe praktikë profesionale;
- d. Njohuritë dhe aftësitë që duhet të përfitojë kandidati për drejtues në Programin e Trajnimit të Detyrueshëm Përgatitor;
- e. Metodologjinë e të nxëniet e përdorur në program;
- f. Format e monitorimit dhe të vlerësimit të pjesëmarrësve në trajnim;
- g. Kalendarin e zhvillimit të trajnimit të përcaktuar në ditë dhe orë;
- h. Mjetet dhe pajisjet e ofruara nga institucioni që do të zhvillojë trajnimet;
- i. Formën e propozimit financiar nga IAL-të ose subjektet e tjera;
- j. Kriteret e planifikimit dhe të monitorimit të zhvillimit të trajnimit nga vetë institucioni ofrues;
- k. Kriteret dhe përgjegjësitë që duhet të plotësojë stafi i angazhuar nga institucioni për ofrimin e trajnimit të detyrueshëm përgatitor.

Neni 9

“Përzgjedhja e IAL-ve apo subjekteve të tjera”

1. Komisioni i ngritur për shqyrtimin e dokumentacionit përgatit vlerësimet për përzgjedhjen e IAL-ve apo subjekteve të tjera.
2. Shkolla e Drejtorëve përzgjedh dhe njofton institucionin fitues brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga marrja e vendimit.
3. Kontrata lidhet për një kohëzgjatje 1 (një) vit nga data e nënshkrimit, me të drejtë rinovimi.

Neni 11

Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes

⁷ Shpallja e interesit për zhvillimin e Programit të trajnimit të detyrueshëm përgatitor për certifikimin e drejtuesve të IAP.

1. Kanë të drejtë të aplikojnë për Programin e Trajnimit të Detyrueshëm Përgatitor për pajisjen me certifikatë për drejtimin e Institucioneve të Arsimit Parauniversitar, kandidatët të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë Rregullore.

2. Kandidatët duhet të plotësojnë këto kriterë:

a. Kanë përfunduar në Republikën e Shqipërisë, një program të ciklit të dytë ose kanë ndjekur një program studimi 4 vjeçar në fushën e mësuesisë dhe janë pajisur me diplomën përkatëse, ose janë diplomuar jashtë vendit në një program të ciklit të dytë në fushën e mësuesisë dhe kanë kryer njehsimin e diplomës pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore.

b. Kanë përvojë pune si mësues dhe kanë së paku kategorinë “Mësues i Kualifikuar”.

c. Nuk kanë masa disiplinore në fuqi në momentin e aplikimit.

d. Të kenë notë mesatare aritmetike të studimeve të ciklit të parë dhe të dytë ose ekuivalente me to jo më pak se 7.5 (kriter preferencial)

Neni 14

Shqyrtimi i aplikimeve dhe vlerësimi me dosje

1. Procedura e vlerësimit të aplikimeve të kandidatëve për ndjekjen e Programit të Trajnimit kalon përmes shqyrtimit nga Komisioni i Vlerësimit.

2. Komisioni i Vlerësimit ka në përbërje të tij 3 (tre) anëtarë: • 1 përfaqësues të zgjedhur nga Shkolla e Drejtorëve dhe • 2 përfaqësues të zgjedhur nga MAS.

3. Shkolla e Drejtorëve mund të krijojë sipas rastit dhe më shumë se një Komision Vlerësimi.

4. Shkolla e Drejtorëve mund të ngrejë komisione vlerësimi ad-hoc, me kërkesë individuale të pjesëmarrësve dhe apo nga MAS.

Shkolla e Drejtorëve, pas përfundimit të afatit të aplikimit, përgatit për Komisionin e Vlerësimit listat dhe dosjet e kandidatëve.

5. Komisioni i vlerësimit, shqyrton dokumentacionin dhe bën vlerësimin e kandidatëve brenda afatit 30 ditor nga mbyllja e aplikimeve sipas kategorive përkatëse.

Neni 16

Procedura e ankimimit

1. Kandidatët kanë të drejtën e ankimimit te Shkolla e Drejtorëve brenda 5 (pesë) ditëve pune nga marrja e njoftimit.

2. Shkolla e Drejtorëve shqyrton ankimimin bazuar në pretendimin e kandidatit dhe mbështetur në dokumentacionin e aplikimit dhe kthen përgjigje brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga marrja e ankesës nga kandidati.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vëren se, pretendimet e subjektit ankues, sa i takon procedurës apo mënyrës së përlllogaritjes së pikëve të dosjes së tij, në thelb janë pretendime që mund të lidhet me ligjshmërinë apo jo të veprimeve, përlllogaritjen e gabuar të pikëve të dosjes së tij, nga ana e Komisionit të Vlerësimit të aplikimeve të kandidatëve, gjë e cila për pasojë ka çuar në moskualifikimin e tij si kandidat fitues për Programin e Trajnimit të Detyrueshëm Përgatitor për pajisjen me certifikatë për drejtimin e Institucioneve të Arsimit Parauniversitar,

por nuk lidhen me cilësitë e karakteristikat e identifikueshme të ankuesit në kontekst të shkakut të mbrojtur sipas LMD-së.

Bazuar në sa më lart, nisur nga shpjegimet që jep ankuesi se ai plotëson kriterin e arsimit të kërkuar dhe se ka eksperiencë e kualikime të mjaftueshme, sipas kriterëve të kërkuara në apliminin e shpallur për thirrjen e III-të, 15 janar – 15 shkurt 2025, Komisioneri, vlerëson se, përmbushja e tyre është kërkesë e cila shkon në përputhje me kërkesat që duhen plotësuar nga kandidati që të jetë pjesëmarrës në programin e trajnimit, dhe se, pasja apo posedimi i tyre nuk përbën një “shkak të mbrojtur” sipas LMD-së, në kuptimin që t’i kenë dhënë ankuesit një “status” apo t’i kenë veshur atij cilësi personale apo karakteristika të identifikueshme, të dallueshme individuale⁸. Përmbushja e këtyre kërkesave është kriter paraprak dhe detyrim për mësuesin kandidat për të marrë pjesë në këtë program trajnimi të detyrueshëm përgatitor për t’u certifikuar si drejtues i IAFP-së.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pretendimi i ankuesit për diskriminim për shkak të “gjendjes arsimore” sipas kuptimit të LMD-së, nuk rezulton i provuar bazuar në provat e depozituara prej tij.

Pala ankuese nuk parashtron e argumenton bindshëm me fakte e prova, se mbart shkakun e pretenduar, mbi të cilat të mund të vijohej me hetimin e ankesës, nëse ai është trajtuar në mënyrë të padrejtë apo të diferencuar nga ana e subjekteve kundër të cilëve ka paraqitur ankesën⁹, lidhur me mënyrën e përlllogaritjes së pikëve të dosjes së tij, (përlllogaritje e gabuar sipas tij, e cila ka çuar në moskualifikimin e tij si kandidat fitues për Programin e Trajnimit të Detyrueshëm Përgatitor për pajisjen me certifikatë për drejtimin e Institucioneve të Arsimit Parauniversitar) trajtim i cili të jetë motivuar pikërisht nga gjendja arsimore.

Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese.

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/ç, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se:

“4. Ankesa nuk pranohet nëse:ç)nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

- *Lidhur me kërkesën e subjektit ankues për vënie në dispozicion të dokumentacionit të plotë mbi mënyrën e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Aplikantëve pranë Shkollës së Drejtorëve, nga subjektet respektive,*

⁸ Për analogji citojmë Vendimin nr. 264, datë 28.12.2023 dhe Vendimin nr. 27, datë 23.01.2024, të KMD-së.

⁹ Shkollës së Drejtorëve të Institucioneve të Arsimit Parauniversitar dhe Agjencisë Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional

Komisioneri, vëren se, ky kërkim i z. D. Ll nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj nga KMD, pasi ky kërkim i ankuesit ka të bëjë me moszbatimin apo shkeljet e dispozitave ligjore të ligjit nr. 119/2014 *"Për të Drejtën e Informimit"*, të ndryshuar, sa i takon pretendimit të tij për mosdhënie të informacionit e dokumentacionit të kërkuar në mënyrë të plotë¹⁰.

Komisioneri, vëren se, çdo person, kur vlerëson se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ligji nr.119/2014 *"Për të Drejtën e Informimit"*, të ndryshuar, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si Institucioni dhe organi kompetent i krijuar me ligj të posaçëm.

Ankimi bëhet në rastet kur subjekti juridik, institucioni:

- refuzon dhënien e informacionit;
- nuk përgjigjet;
- kthen përgjigje pa vënë në dispozicion dokumentin e kërkuar;
- kthen përgjigje të paplotë.

Ankimimi pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda afateve ligjore të përcaktuara në këtë Ligj.

Për rrjedhojë, për sa më sipër, ankuesi mund t'i drejtohet institucionit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi hetimi sa më sipër nuk bën pjesë në kompetencat e KMD-së.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç/ të ligjit nr.10 221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues D. Ll, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

¹⁰ Për analogji citojmë: Vendimin nr. 17, datë 25.01.2023, Vendimin nr. 288, datë 02.12.2024, Vendimin nr. 175, datë 05.08.2025, të KMD-së.